

VENDIM
Nr.777, datë 11.10.2006

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.230, DATË 4.4.1998 “PËR
PRIVATIZIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË ZOTËRUAR NGA SHTETI, NË
SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.230, datë 4.4.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Privatizimi i pjesëve të kapitalit, të zotëruar nga shteti, në shoqëritë me kapital të përbashkët, të formës sh.p.k. dhe sh.a., bëhet duke u mbështetur në dispozitat e Kodit Civil dhe në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.”

2. Pika 3 të riformulohet, si më poshtë vijon:

“3. Pas miratimit të kërkesës për privatizim, shoqëria, me kërkesë të ortakut shtetëror, cakton 2 ekspertë, vlerësues të pasurisë dhe kontabël të autorizuar, për përcaktimin e vlerës së shoqërisë, për efekt të shitjes së pjesëve të kapitalit shtetëror. Çasti i caktimit të ekspertëve shënon fillimin e procesit të privatizimit.”.

3. Pika 7 të riformulohet, si më poshtë vijon:

“7. Vlera e shitjes së pjesës shtetërore, në shoqëritë me kapital të përbashkët, përcaktohet sipas standardeve europiane të vlerësimit të pasurisë dhe standardeve të raportimit financiar (metoda e vlerësimit të tregut). Investigimet të bazohen në vlerën e kontributit të palës shqiptare, të vendosur nga çasti i themelimit të shoqërisë, dhe në kapitalin e investuar në vite, deri në fillimin e procesit të privatizimit.

Vlera minimale e pjesëve të kapitalit, të zotëruar nga shteti, që do të privatizohen, në asnjë rast, nuk do të jetë më e vogël se vlera e kontributeve të palës shqiptare, e vendosur në çastin e themelimit të shoqërisë.

Shitja e pjesëve të kapitalit, të zotëruar nga shteti, bëhet me lekë.”.

4. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Përfaqësuesi i pronarit për pjesën e kapitalit shtetëror miraton ndryshimin e përqindjes së kapitalit shtetëror apo çdo transaksioni tjetër, që çon në ndryshim të kuotave në shoqëritë me kapital të përbashkët.”.

5. Në pikën 22 të bëhen këto ndryshime:

a) Fjalët “Ministria e Ekonomisë” zëvendësohen me “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”;

b) Fjalët “Agjencia Kombëtare e Privatizimit” zëvendësohet me “Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha